

Manni-Plex™ Ca



Solucion ushqyes gjethor

EC FERTILIZER

Analizë e Garantuar

Azot total (N) 8,0% p/p
8,0% p/p Azot Nitrik
Oksid kalciumi i tretshëm në ujë (CaO) 14,0% p/p

TRETËSIRË AZOTI ME ELEMENTË SEKONDARË, N(CaO), 8 (14).

Lexoni me kujdes udhëzimet e etiketës së produktit përpara përdorimit të tij. Përdorimi i rezervohet vetëm kultivuesve dhe personelit të autorizuar për aplikim. Për sigurinë humane dhe mjedisore, ndiqni udhëzimet e sigurisë në këtë etiketë. Të ruhet në temperaturë nga 5°C deri 35°C. Ky produkt do të përdoret vetëm në rastet e shfaqjes së kërkësve të kulturave. Mos aplikoni norma më të larta se ato të rekomanduara në etiketë.

Nr.1456/1, Dt. 29.08.2024

Informacion i Përgjithshëm

Manni-Plex Technology mobilizon kalciumin që përmbahet në produktin MANNI-PLEX Ca, duke përmirësuar në masë të madhe lëvizshmërinë e tij, nëpërmjet Floemës, në fruta dhe në pjesët e brëndshme të perimeve si p.sh Sallatë e jeshile dhe Lakër, me rezultat rritjen e sasisë së kalciumit që shkon në pulpën e frutave dhe veçanërisht në muret qelizore dhe në membranat plazmatike, duke promovuar në këtë mënyrë, një akumulim më të mirë të kalciumit në vakuola, mitokondri si dhe në muret qelizore nëpërmjet rrugëve të apoplastit dhe simplastit.

Distributor:

PLANTA Sh.P.K

Shpermdare nga

PLANTA Sh.P.K

Lgja "18 Tetori", Ruga "Vath Korreshi" nr. 3/1

Lushnje-Albania

Tel & Fax: +355 35 212 004

Email: plantashpk@hotmail.com

Përmbajtja Neto: 1 litër

Pesha Neto: 1,4 kg

FORMULATED IN USA

MANUFACTURED IN EU

MANNI-PLEX Ca ndihmon kalciumin të anashkalojë nivelet e larta të natriumit të cilat priren të pengojnë lëvizjen e tij në membranat qelizore. Dhe „meqënëse sheqernat (polyols) e pranishme në MANNI-PLEX Ca luajnë një funksion osmoprotektant, ato ndihmojnë në rivendosjen e ekuilibrit osmotik nën gjendjen e thatësirës dhe kripëzimit, duke rritur në këtë mënyrë presionin e turgorit dhe atë osmotik në bimë.

MANNI-PLEX Ca ndihmon në rritjen e efikasitetit të Kalciumit dhe për rrjedhojë parandalimin dhe korrigjimin e çrregullimeve ushqyese, siç janë: Gropëzimi i hidhur (Bitter pit), Djegia sipërfaqësore e frutit, Çarja e kokrrës (Cracking), Kalbëzimi i majës së kokrrës (Tapëzimi), si dhe shumë sëmundje të tjera rrënjore. MANNI-PLEX Ca gjithashtu ndihmon në rritjen e qëndrueshmërisë së tulit të frutit dhe të jetëgjatësisë së tij.

Nr. i Serisë:

Data e Prodhimi:

AFATI I RUAJTJES: 5 VJET

Prodhuar nga:

BRANDT™

BRANDT Europe, S.L.

Ctra. Carmona - Guadajoz, Km 3.1

41410 Carmona (Sevilje) Spanje

+34 954 196 230

www.brandt.co

1ALB2403361